

13189

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE

13189/1

V E N D I M
I Gjyqtarit te vetem

Une gjyqtare e Gjykates se rrethit Tirane Mr. Dea, sot me date 23.2.96 mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Drejtori i Drejtorise se Shoqerive Publike z. Berzh Piranian, lidhur me depozitimimin e urdherit te Ministrit te Financave, z. Dylber Vrioni dhe

K O N S T A T O V A

se me vendimin nr 13189 date 06.12.1995 te Gjykates se rrethit Tirane, shoqeria anonime, Parku i udhetareve Shkoder eshte regjistruar si person juridik, me kapital themeltar 18801000. leke.

Me urdherin nr 95/1, date 29.1.1996, te Ministrit te Financave eshte vendosur zmadhimi i kapitalit themeltar te shoqerise Parku i udhetareve Shkoder sh.a, duke futur ne kapitalin themeltar edhe vleren e truallit te objektit Parku i udhetareve Shkoder, prone e shtetit, perfaqesuar nga Ministri i Financave, e cila sipas vleresimit te bere kap shumen 4439040 leke, dhe kapitali themeltar behet gjithsej 23240040 leke.

Nga shqyrtimi i akteve te depozituara rezulton se kerkesa e paraqitur eshte e bezuar dhe dokumentacioni i paraqitur eshte i plote.

Per keto arsye

Ne baze te nenit 24 te ligjit 7667 date 28.01.1993 dhe ligjit 7638 date 19.11.1992

V E N D O S A

Depozitimimin ne zyren e regjistrimit tregtar te urdherit nr 95/1, date 29.1.1996, te Ministrit te Financave lidhur me zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise anonime Parku i udhetareve Shkoder, duke u bere shenimi perkates ne fleten e regjistrimit ne kollonen nr 4 dhe 5 me nr rendor 2. Te ndahen regjistrimet me vije nga njeri tjetri. Te publikohet vendimi i mesiperm.

GJYQTARE

Marjans. Dea
[Signature]